

VENDIM
Nr. 498, datë 1.8.2012

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE KOMUNA FARKË, TIRANË, TË PRONËS NR. 193, ME EMËRTIM “GROUP DEPO M (ISH-REPARTI USHTARAK NR. 5011/53)”, NË LUNDËR, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, shkronja “c”, 3, 5, 7 e 8 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te komuna Farkë, Tiranë, të pronës nr. 193, me emërtim “Group Depo M (Ish-Reparti Ushtarak nr. 5011/53)”, në Lundër, Tiranë, sipas formularit standard të inventarizimit, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për krijimin e Qendrës së Shërbimeve të Integruara, zyra administrate, stacion policie, stacion zjarrfikës, qendër shëndetësore, çerdhe e kopsht.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet prona nr. 193, me emërtim “Group Depo M (Ish-Reparti Ushtarak nr. 5011/53)”, Lundër, Tiranë.

3. Komunës Farkë, Tiranë, i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës nr. 193, me emërtim “Group Depo M (Ish-Reparti Ushtarak nr. 5011/53)”, në Lundër, Tiranë, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose ta japë në përdorim te të tretë.

4. Dorëzimi i mjediseve dhe i truallit funksional të pronës të bëhet pas heqjes së materialeve dhe të pajisjeve të Forcave të Armatosura, të magazinuara në këtë pronë.

5. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme, kryetari i komunës Farkë, Tiranë dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha